

UDHËZIM
Nr. 11, datë 7.2.2025

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË
NXËNËSVE NË ARSIMIN FILLOR, VITI SHKOLLOR 2024–2025**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor më datë 22 maj 2025, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.
2. Testi është i integruar dhe përfshin njohuri nga lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.
3. Për nxënësit e pakicave kombëtare greke dhe maqedonase pjesa e testit që përfshin njohuri nga lëndët e matematikës dhe të diturisë së natyrës të jetë në gjuhën e tyre amtare.
4. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, fillon në orën 10:00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.
5. Nxënësi duhet të paraqitet 1 (një) orë përpara në qendrën ku zhvillohet vlerësimi.
6. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testit përcaktohen në rregulloren “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor”, miratuar me urdhrin nr. 66, datë 13.2.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.
7. Qendra Burimore për Nxënësit që Nuk Shikojnë tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit *Braille*.
8. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me programin mësimor me të cilin punojnë, veçoritë dhe nevojat e tyre, sipas përcaktimeve të rregullores “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor”.
9. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.
10. Arkivimi i testeve bëhet pranë zyrave vendore të arsimit parauniversitar.
11. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve në arsimin fillor. Këto të dhëna dërgohen në QSHA, në AKAP dhe në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.
12. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Orjana Osmani